



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/K9-7 Prot.

Tiranë 23 /06/2022

Nr. Dok. 202100561/7

Lënda : *Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë Rajonale Gjirokastrë, të Furnizuesit të Shërbimit Universal, për moskthim përgjigje.*

FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A. (OSHEE GROUP)

TIRANË

**Për dijeni: Drejtorisë Rajonale Gjirokastrë, të Furnizuesit të Shërbimit Universal ,
(Oshee Group)**

GJIROKASTËR

Z. K. K

DROPULL I SIPËRM

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesave të tyre të ligjshme, ka marrë në administrim ankesën

e shtetasit K.K, i cili ankohet ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal, Sh.a, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, (oshee).

Në ankesën e tij parashtron ndër të tjera se: “Ai është banues në fshatin Selo, në Dropullin e Sipërm dhe ankohet për mbifaturim të energjisë elektrike për muajin shkurt të vitit 2021. Ai ka një kontratë për furnizimin me energji elektrike me Nr. M 051544, e cila është në emër të babait të tij, të ndjerit J. K, i cili është ndarë nga jeta në vitin 2001. Më tej shpjegon se është pagues i rregullt ndaj detyrimeve të OSHEE –së. Ky shtetas parashtron se në shumicën e kohës është në emigracion, në Greqi dhe shtëpia e tij qëndron e mbyllur dhe aty nuk banon njeri. Ai është kthyer nga Greqia më datë 10.03.2021, dhe kur është paraqitur në zyrën postare për të paguar detyrimet që ka ndaj OSHEE-së, është vënë në dijeni të faktit se për muajin shkurt të vitit 2021, pagesa e tij për konsumin e energjisë elektrike ka qenë në vlerën prej 5,184.40 lekë. Ankuesi pretendon se nuk i ka konsumuar këto kWh të energjisë elektrike, pasi ai nuk ka qenë fare në Shqipëri. Në lidhje me këtë problematikë ai i është ankuar pranë Zyrës së Pritjes së Qytetarëve të FSHU, në Gjirokastrë dhe sipas tij, përgjigja që ka marrë në lidhje me mbifaturimin ka qenë që të mos e paguante këtë detyrim. Në lidhje me këtë shpjegim ai ka kërkuar që t’ia jepnin me shkrim, por i janë përgjigjur se ata janë të punësuar dhe nuk mund t’ia jepnin një shkresë të tillë. Në këto kushte ai pretendon se po sorollatet për të gjetur të drejtën e tij”.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal ashtu edhe në atë substancial për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenet 13, 17/a dhe 18/b të ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ka vendosur t’a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes¹.

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63/4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: “*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*”, si dhe nenit 19 /b të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të*

¹ Neni 13 i Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur verën ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”

marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”, në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, i jemi drejtuar Furnizuesit të Shërbimit Universal Sh.a, Drejtorisë Rajonale Gjirokastrë, me disa shkresa, por nuk kemi marrë përgjigje edhe pse ka kaluar çdo afat i arsyeshëm ligjor.

Konkretisht kemi dërguar shkresën e parë me Nr. K3/K9-2 prot., datë 21.04.2021, *“kërkesë për shpjegime”*. Në kushtet kur Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.a, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, nuk iu përgjigj kërkesës së Avokatit të Popullit, i jemi ridrejtuar sërish me shkresën Nr. K3/K9-4 prot., datë 12.07.2021, *“Kërkesë e përsëritur për shpjegime”*, Nr. K3/K9-5 prot., datë 04.11.2021, Nr. K3/K9-6 prot., datë 21.02.2022, dhe dhe në zbatim të nenit 19/2 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”*, kemi kërkuar që informacioni i kërkuar të na vihet në dispozicion brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga marrja e kësaj shkrese, por përsëri ju bëjmë me dije se nuk është kthyer përgjigje.

Nga shqyrtimi në tërësi i rrethanave sa sipër vlerësojmë se ky qëndrim i mbajtur nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, Sh.a, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, ka cënuar rëndë parimin e respektimit të hierarkisë institucionale si dhe të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe bie ndesh me dispozitat kushtetuese, Kodin e Procedurave Administrative si dhe Ligjin Nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar,. Konkretisht në nenin 63 të Kushtetutës është parashikuar se: *“Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit. 2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme. 3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike. 4. **Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij**”.*

Në interpretim të dispozitës së mësipërme vlerësojmë se parimi i bashkëpunimit në këtë rast është një detyrim ligjor kushtetues për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtim. Rëndësia e këtij parimi konsiston edhe në instrumentat ligjore që kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, si garanci në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës

publike apo funksionarët publikë, siç janë raportet vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet apo propozimi për marrjen e masave administrative ndaj nëpunësve përgjegjës.

Në këtë frymë janë edhe parashikimet e dispozitave të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në përmbajtje të të cilit ka gjetur rregullim ligjor e drejta e institucionit tonë për marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike apo nëpunësit e tyre. Kështu neni 22 i këtij ligji parashikon se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”*.

Sjellim në vëmendjen tuaj faktin se dispozitat e Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, zbatohen edhe për personat juridikë publikë apo privatë, të cilët ofrojnë shërbime publike.

Mosdërgimi i përgjigjeve dhe informacionit të kërkuar ka sjellë si pasojë mos trajtimin e kësaj ankese brenda afatit ligjor dhe mungesën e korrektesës së institucionit tonë kundrejt ankuesit. Kjo sjellje, çënon rëndë marrëdhëniet tona ndërinstitucionale, si dhe imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik, pasi ka sjellë si pasojë zvarritjen e hetimit administrativ dhe është bërë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme, si dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankuesit.

Në kushtet kur edhe pse ka kaluar 12 (dymbëdhjetë) muaj nga fillimi i procedimit administrativ, dhe deri më sot nuk kemi marrë akoma asnjë përgjigje, konkludojmë se është mëse evidente neglizhenca apo mungesa e bashkëpunimit me Institucionin e Avokatit të Popullit.

Referuar problematikës së hasur, në respektim të afateve procedurale të kthimit të përgjigjes, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga ju në ushtrim të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave funksionale, **marrjen e masave disiplinore**, për mosveprim në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi, për punonjësit përgjegjës të ngarkuar për kthim të përgjigjes së kërkesave të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Në vështrim të nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, në koneksitet me nenin 22/2 të ligjit *“Për Avokatin e Popullit”*, me titull: *“Sanksionet për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit”*, në të cilin parashikohet se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”*

REKOMANDOJMË:

- Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës, të Furnizuesit të Shërbimit Universal Sh.a, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, lidhur me mospërmblidhjen e detyrimit ligjor, për t'i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.
- Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërke si dhe masat disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, konform nenit 21 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.
- Në zbatim të nenit 21/c të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, paraqitja e këtij rekomandimi pezullon aktet apo veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në momentin e shqyrtimit të këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.

Bashkëlidhur ju dërgojmë: fotokopje të shkresave të cituara sa sipër respektivisht me Nr. K3/K9-2 prot., datë 21.04.2021, Nr. K3/K9-4 prot., datë 12.07.2021, Nr. K3/K9-5 prot., datë 04.11.2021, Nr. K3/K9-6 prot., datë 21.02.2022.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

KOMISIONERI

Prof.Asoc.Dr. Erjona BANA (CANAJ)

d.v